



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin korrik 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, kam kënaqësinë të ndaj me ju raportin e muajit korrik 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Në muajin korrik, së bashku me Protik ICT Center, në një event online diskutuam mbi rezultatet e raportit mbi impaktin e COVID-19 mbi start up-et, ndikimet kryesore që kanë pasur këta fundit nga situata e krijuar si dhe masat mbështetëse që po përgatisim me anë të projektligjit "Mbi Zhvillimin dhe Mbështetjen e Start Up-eve Inovative". Protik ICT Center dhe pjesëmarrësit start-up, tregojnë se vijojmë të krijojmë ura komunikimi cilësore me të gjithë aktorët në fushën e start up-eve si dhe mirëpresim angazhimin e tyre në procesin e konsultimit publik, që do të fillojë në muajt në vijim.

Në kuadër të bashkëbisedimit të vazhdueshëm me shoqatat, organizuam një takim online me pjesëmarrjen e anëtarëve të Shoqatës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri, ku bizneset u shprehën mbi problematikat që kanë hasur gjatë kësaj periudhe si dhe në lidhje me masat e paketat e ndërmarra nga qeveria për mbështetjen e biznesit. Bizneset gjatë këtij takimi me anë të një formati pyetjesh na shprehen shqetësimet e tyre të cilat u trajtuan si gjatë takimit, por edhe në vijim duke kontaktuar me institucionet respektive.


Gjithashtu, Dhoma Amerikane e Tregtisë prezantoi Indeksën e Biznesit për vitin 2019, në një event ku së bashku me Ambasadorën e SHBA-së si dhe përfaqësues të Dhomës

diskutuam mbi indikatorët me rritje si marrëdhëniet me administratën tatimore apo doganore në këtë indeks, si dhe elementët të cilët kanë nevojë për përmirësim me qëllim forcimin e besueshmërisë së investitorëve të huaj në tregun vendas. Rëndësia e këtyre takimeve të vazhdueshme me dhomat dhe shoqatat qëndron në identifikimin e tipologjisë së problematikave dhe adresimin më të shpejtë të tyre.

Ndërkohë kemi vijuar në mënyrë intensive edhe vizitat në sipërmarrje, gjatë të cilave diskutojmë mbi çështjet që ndikojnë ecurinë e biznesit, si dhe mundësive për zgjidhje afatgjata të këtyre problematikave. Kemi ndjekur gjithashtu me prioritet punën e rrjetit të koordinatorëve të dedikuar për biznesin, duke pasur takime të shpeshta me koordinatorët e Ministrive por edhe të institucioneve kryesore për t'u siguruar se cdo ankesë ndiqet me vëmendjen e duhur.


Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,
Eduard Shalsi




Analiza e Ankesave Korrik 2020


1. Shperndarja e ankesave në baza javore



2. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



3. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe bashkive



4. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe institucioneve të varësisë.

